



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLAD. KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS - KORREKТИVNA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE

Njësi e Orgjedidica/Org.Unit:

68 Nj./Bz./Nro: 753

Dati/Datum/Date: 06/07/22

Shëtjeje/Undësi/Issue:

PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service

**PLANI I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E GRAVE NË
GJITHA NIVELET E SHËRBIMIT KORREKTUES TË
KOSOVËS**

Prishtinë, Qershor 2022

HYRJE

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është e drejtë themelore dhe vlerë thelbësore për çdo Institucion, ligji për Barazinë Gjinore parasheh përfaqësim të barabartë gjinor në çdo nivel në institucionet publike, për t'u arritur kjo e drejtë duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet. Shërbimi Korrektues i Kosove në situatën aktuale ka 12.7 % gra dhe 87.3 % burra, ndërsa në pozita udhëheqë përfaqësimi nga gratë është 17 % ndërsa nga burrat 83 %.

Me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis grave dhe burrave në këtë gjendje të pabarazisë drejtoria e përgjithshme do të merr masa të veçanta të përkohshme për rritjen e numrit të grave si dhe fuqizimin e grave në pozita drejtuese, përmes pranimit të zyrtareve gra, rritjes se pjesëmarrjes se grave në trajnime menaxheriale si dhe përfshirjes se tyre pozita udhëheqëse.

Plani i Shërbimit Korrektues është bazuar në Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Plani i Veprit të miratuar nga Qeveria e Kosovës me vendimin nr.01/34 të datës 23.05.2020, i cili synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.

Arsyet për Planin e Veprimit

Arsyet për Planin e Veprimit janë që të udhëzohet implementimi i mëtejshmë i politikës përfshirjen e numrit të grave, rritjen e pjesëmarrjes se grave ne trajnime si dhe rritjen e numrit te grave ne pozita drejtuese në SHKK.

Vizioni, objektivat dhe aktivitetet

Vizioni i këtij plani të veprimit është që të gjithë zyrtarët gratë dhe burrat do të kenë mundësinë përmarrë pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, të drejta të barabarta, në trajnime dhe avancime.

Plani i veprimit përmes tri objektivave specifike të tij synon të arrijë:

- Të rritë punësimin e grave në nivel të SHKK-së;
 - Fushatë mediale dhe në rrjetet sociale për inkurajimin e grave përfshirjen në SHKK.*
 - Hapjen konkursit për punësim vetëm për gra.*
- Të rritë pjesëmarrjen e grave në trajnime menaxheriale;
 - Motivimi për avancim në karrierë përmes takimeve;*
 - Organizimi i trajnimeve të vecanta për pozitat udhëheqëse;*
 - Emërimi i grave në pozita udhëheqëse*
- Promovimi i grave në pozita udhëheqëse.
 - Promovimi i rasteve te suksesshme te grave përmes uebfaqes dhe rrjete sociale*

Objektiva specifike	Treguesit bazë	Treguesit e synuar për vitet 2022-2023	Treguesit e synuar për vitet 2024-2026
Rritja e punësimit të grave në nivel të SHKK-së			
<i>Fushatë mediale dhe në rrjetet sociale për inkurajimin e grave për aplikim në ShKK</i>	Nuk ka	Të paktën një fushate ne media brenda një viti	Të paktën një fushate ne media brenda një viti
<i>Hapjen konkursit për punësim vetëm për gra.</i>	Numri aktual i grave: 201	Numri i grave te punësuara i synuar: 30 zyrtare korrektuese Numri te rritet ne 231	Numri i grave te punësuara i synuar: 50 zyrtare korrektuese Numri të rritet në 281
Të rritë pjesëmarrjen e grave në trajnime menaxheriale;			
<i>Motivimi për avancim në karrierë përmes takimeve</i>	Nuk ka takime te mbajtura	Të paktën dy takime brenda vtitit për secilin Institucion Korrektues	Të paktën dy takime brenda vtitit për secilin Institucion Korrektues
<i>Organizimi i trajnimeve të veçanta përpozitat udhëheqëse</i>	Trajnimet janë realizuar nga shoqata e grave përmes donacioneve	Të paktën dy trajnime te organizuara brenda vtitit	Të paktën dy trajnime te organizuara brenda vtitit
<i>Emërimi i grave në pozitat drejtuese të institucioneve korrektuese</i>	Tri pozita zëvendës drejtor; Shtatë pozita udhëheqëse;	Të paktën pozita Drejtor në Qendrën përgjithshëm te jetë grua; Të rritet në dy mbëdhjetë grue pozita udhëheqëse;	Një nga pozita zëvendës drejtor i përgjithshëm te jetë grua; Pozita Drejtor në Qendrën korrektuese për

	<p>Tri pozita Mbikëqyrës i larte;</p> <p>Pesë pozita Mbikëqyrës</p>	<p>Të rritet në gjashtë pozita mb.lartë;</p> <p>Të rritet në dhjetë pozita mbikëqyrës</p>	<p>Të mitur të jetë grua;</p> <p>Të behet përpjekje që të një nga pozitat udhëheqëse (nivel divizioni) në secilin institucion të jete grua;</p> <p>Të rritet në dhjetë pozita mb.lartë;</p> <p>Të rritet në pesëmbëdhjetë pozita mbikëqyrës</p>
Promovimi i grave në pozita udhëheqëse			
<p><i>Promovimi i rasteve të suksesshme te grave përmes uebfaqes dhe rrjete sociale</i></p>	Nuk ka	<p>Promovimi i së paku një gruaje një herë në dy muaj nga një institucion korrektues apo njësi e SHKK-së</p>	<p>Promovimi i së paku një gruaje një herë në dy muaj nga një institucion korrektues apo njësi e SHKK-së</p>

Hartimi i planit

Ridvan Hoti

Udhëheqës i njësisë se burimeve njerëzore

Miratimi i planit

Sami Gashi

Zëvendësues Drejtor i Përgjithshëm